



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 17, dt. 10.06.2024

**MBI MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KALUAR
DEKLARIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT TË KËSHILLTARVE TË KËSHILLIT
TË QARKUT KORÇË**

Këshilli i Qarkut Korçë në mbledhjen e datës së sotme, pasi shqyrtoi me këshilltarët dhe miratoi propozimet e paraqitura nga Kryesia si dhe pikat e rendit të ditës të njoftuara për vendimmarrje në njoftimin e datës 15.03.2024, në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore" neni 76,

VENDOSI

1. Të miratojë procesverbalin e mbledhjes të Këshillit të Qarkut Korçë të datës 15.03.2024 bashkëngjitur projektvendimit.
2. Mbi Deklarimin e Konfliktit të Interesit të Këshilltarve të Këshillit të Qarkut Korçë
3. Kopja e procesverbalit administrohet nga Sekretari i Këshillit të Qarkut sipas procedurave ligjore.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit.

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

Erjon Nexhipi



Miratuar me / 15 / Vota
Vota Pro / 15 /
Vota Kundër / 0 /
Vota Abstenim / 0 /
Zbardhur më datë /10/ 06/2024

Konceptoi: Sek.KQK: B. Muço



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

Nr _____ Prot.

Korçë, më 10/06/2024

Lënda: Mbledhja-Nr-2

Procesverbal Nr 5 më datën 10/06/2024 ora 13:00

Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes dhe vendimeve së datës 15.03.2024.

Procesverbal i mbajtur sot më datën 10/06/2024 ora 13 00 nga Sekretari i Këshillit të Qarkut Korçë në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Qarkut Korçë, për miratimin e (procesverbalit dhe vendimet e mbledhjes së datës 15.03.2024)

1. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes dhe vendimeve së datës 15.03.2024.
- Më datën 06/03/2024 me Nr. 85/1 prot, është thirrur mbledhja e kryesisë të Këshillit të Qarkut Korçë nga Kryetari i Këshillit të Qarkut Korçë Z. Erjon Nexhipi
 - Më datën 13.03.2024 ora 12:00 është zhvilluar mbledhja e kryesisë të Këshillit të Qarkut Korçë .
 - Më datën 06/03/2024 me Nr. 86/2 prot, është thirrur mbledhja e Këshillit të Qarkut Korçë nga Kryetari i Këshillit të Qarkut Korçë Z. Erjon Nexhipi
 - Më datën 15/03/2024 ora 12:00 është zhvilluar mbledhja e këshillit të Këshillit të Qarkut Korçë
 - Më datën 18/03/2024 me Nr. 188 Prot, janë dërguar vendimet e Këshillit të Qarkut Korçë, për verifikimin e bazueshmërisë ligjore. Drejtuar Prefektit të Qarkut Korçë
 - Më datën, 27/03/2024 Nr 279/1 Prot, Prefektura e Qarkut Korçë, ka kthyer përgjigje për verifikimin e bazueshmërisë ligjore, të vendimeve të Këshillit të Qarkut Korçë.

Të pranishëm nga administrata e Këshillit të Qarkut Korçë:

- Drejtor i kabinetit të kryetarit-Këshilltar juridik-
- Këshilltar për Teknologjinë dhe Komunikimin
- Këshilltar për Projektet e Bashkimit European
- Specialist Arkiv/Protokoll
- Përgjegjes i Sektorit të Financës dhe Buxhetit
- Specialist i nivelit të lartë për Shërbimet, Burimet Njerëzore dhe Emergjencat Civile
- Specialist i nivelit të lartë për Urbanistikën dhe Zhvillimin e Teritorit
- Specialist i nivelit të lartë për Programet e Zhvillimit
- Specialist për Shëndetsine dhe çështjet sociale, arsimin dhe Kulturën

Të pranishëm në mbledhje media:4

Të pranishëm në mbledhje qytetarë:C

Nga Sekretari i Këshillit të Qarkut Korçë është bërë list prezenca e anëtarëve të KQK të cilët janë të pranishëm fizikisht në sallën e mbledhjeve Këshillit të Qarkut Korçë, si më poshtë vijon.

Antarët e KQK, që janë prezent në sallë fizikisht .

NR	Emer Mbiemer	Bashkia	Pjesmarrës
			Fizikisht
1	Erjon Nexhipi	Bashkia Koçë	Po
2	Sotiraq Filo	Bashkia Koçë	Po
3	Petrika Tollkuci	Bashkia Koçë	Po
4	Anxhela Taho	Bashkia Koçë	Po
5	Ada Permeti	Bashkia Koçë	Po
6	Alma Burda	Bashkia Koçë	Po
7	Mimoza Shuli	Bashkia Pogradec	Po
8	Jovan Shkëmbi	Bashkia Pogradec	Po
9	Gëzim Topçiu	Bashkia Maliq	Po
10	Dritan Çami	Bashkia Maliq	Po
11	Idlir Limllari	Bashkia Maliq	Po
12	Gentiana Drabo	Bashkia Maliq	Po
13	Rudina Bregu	Bashkia Maliq	Po
14	Trifon Meraku	Bashkia Devoll	Po
15	Taqo Grozdani	Bashkia Pustec	Po

Antarët e KQK, që nuk morën pjesë në votim,

NR	Emer Mbiemer	Bashkia	Pjesmarrës
			Fizikisht
1	Ilir Xhakolli	Bashkia Pogradec	Jo
2	Klea Topi	Bashkia Pogradec	Jo
3	Besnik Xhyra	Bashkia Pogradec	Jo
4	Eduard Duro	Bashkia Devoll	Jo
5	Valbona Spaho	Bashkia Devoll	Jo
6	Erion Isai	Bashkia Kolonjë	Jo
7	Gledjon Tafili	Bashkia Kolonjë	Jo
8	Pali Kolefski	Bashkia Pustec	Jo

Mbas verifikimit nga sekretari i KQK të antarëve të KQK të cilët marrin pjesë fizikisht në sallën e mbledhjeve u konstatua se nga 24 anëtarë marrin pjesë 15 anëtarë, 8 anëtarë mungojnë. Me list prezencë, është kuorumi i nevojshëm dhe për pikat e rendit të ditës për të cilat nevojitet shumica e cilësuar $24 \times 3/5 = 14,4$ për të zhvilluar mbledhjen.

1. Kryetari i Këshillit të Qarkut Korçë Z. Erjon Nexhipi, ka hapur mbledhjen në prani të antarëve të Këshillit të Qarkut Korçë.

Mirëdita të gjithëve, të nderuar kolegë këshilltarë, të nderuar pjesëmarrës, mbështetur në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" kemi thirrur këtë mbledhje të radhës të Këshillit të Qarkut Korçë, me rend dite prej 15 pikash. Para se të fillojmë, verifikojmë kuorumin, kemi 15 Këshilltarë në sallë. Meqëse shumica e këshilltarëve janë prezentë e deklaroj mbledhjen të hapur.

U hodh për diskutim rendi i ditës, dhe pika 1 e rendit të ditës

Kryetari i Këshillit të Qarkut Korçë Z. Erjon Nexhipi . Në lidhje me rendin e ditës ,Ka pyetje ,apo diskutime në lidhje me këtë pikë? i jep fjalën, komisioneve, të cilët thanë nuk kemi gjë për të shtuar i jep fjalën Kryetari i grupit të këshilltarve Z. Gezim Topçiu, i cili tha: nuk kam gjë për të shtuar, i jep fjalën, këshilltarve , të cilët thanë nuk kemi gjë për të shtuar.

-Hidhet në votim, P/Vendim-1 rendi i ditës

Kush është Dakord, pro-15

Kundra-0

Abstenim-0

Miratone me 15 vota pro.

U votua pika 1 e rendit të ditës, me 15 vota pro, kundra 0, kundërshtime 0, abstenime 0.

Me këtë rend dite:

1-Për miratimin e rendit të ditës

2- Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar

3-P/Vendim mbi miratimin e përdorimit të të ardhurave të trashëguara të vitit 2023 shtesë në Buxhetin e vitit 2024.

3.1 Relacion mbi miratimin e përdorimit të të ardhurave të trashëguara të vitit 2023 shtesë në Buxhetin e vitit 2024.

4- P/Vendim mbi miratimin e Rregullores së funksionimit të Këshillit të Qarkut Korçë

4.1 Relacion mbi miratimin e Rregullores së funksionimit të Këshillit të Qarkut Korçë

5- P/Vendim mbi ndryshimin e Strukturës organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë.

5.1 Relacion mbi ndryshimin e Strukturës organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë

6- P/Vendim mbi miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Administratës të Këshillit të Qarkut Korçë.

6.1 Relacion mbi miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Administratës të Këshillit të Qarkut Korçë

7- P/Vendim mbi dhënien në huapërdorje në favor të institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë, katin e parë të godinës e cila është në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë.

7.1 Relacion mbi dhënien në huapërdorje në favor të institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë, katin e parë të godinës e cila është në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë.

8- P/Vendim mbi dhënien e pëlqimit për kalimin në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë të pasurive të identifikuar me Nr.2/12 vol.27 faqe 167, Nr.2/539-Nd, vol.27, faqe 168, trulli nën ndërtesën Nr.2/708-N1, pjesë e pasurisë Nr.2/10, vol.33, faqe 19.

8.1 Relacion "Për dhënien e pëlqimit për kalimin në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë të pasurive të identifikuar me Nr.2/12 vol.27 faqe 167, Nr.2/539-Nd, vol.27, faqe 168, trulli nën ndërtesën Nr.2/708-N1, pjesë e pasurisë Nr.2/10, vol.33, faqe 19.

9- P/Vendim mbi miratimin e shtesës në buxhet të fondit të ardhur nga donatori, nëpërmjet BSH-së, për rimbursimin e shpenzimeve të projektit CLLD(cultour).

9.1 Relacioni mbi miratimin e shtesës në buxhet të fondit të ardhur nga donatori, nëpërmjet BSH-së, për rimbursimin e shpenzimeve të projektit CLLD(cultour)

10- P/Vendim mbi miratimin e zbatimit të projektit Shërbime ditore Komunitare për Moshën e Tretë, miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

10.1 Relacion mbi miratimin e zbatimit të projektit Shërbime ditore Komunitare për Moshën e Tretë, miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

11 - P/Vendim "Për miratimin e përbërjes së komisionit të mbrojtjes të tokës në qark"

11.1 - Relacion "Për miratimin e përbërjes së komisionit të mbrojtjes të tokës në qark"

12 - P-Vendim mbi miratimin e linjave të transportit rrethqytetës

12.1 Relacion për transportin rrethqytetës

12.2 Lista me oraret e linjave rrethqytetëse

13 – P/Vendim mbi një shtesë në regjistrin e prokurimeve të vitit 2024

13.1 Relacion mbi një shtesë në regjistrin e prokurimeve të vitit 2024

14 - P-Vendim mbi disa ndryshime në buxhetin e Këshillit të Qarkut për vitin 2024

14.1 Relacion mbi disa ndryshime në buxhetin e Këshillit të Qarkut për vitin 2024

15 – P/Vendim miratimin e tavaneve përgatitore për programin buxhetor afatmesëm 2025-2027

15.1 -Tabelat e tavaneve

15.2 -Raporti

-Informacione për Këshillin

- Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2023

- Situata e gjendjes financiare për vitin 2023 (detyrimet e trashëguara)

U hodh për diskutim pika 2 e rendit të ditës.

- Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryetari i Këshillit të Qarkut Korçë Z. Erjon Nexhipi . Në lidhje me procesverbalet e mbledhjes së kaluar .Ka pyetje, apo diskutime në lidhje me këtë pikë? - jep fjalën, komisioneve, të cilët thanë nuk kemi gjë për të shtuar - jep fjalën Kryetarit të grupit të këshilltarëve Z. Gezim Topçiu, i cili tha: nuk kam gjë për të shtuar, i jep fjalën këshilltarëve, të cilët thanë nuk kemi gjë për të shtuar.

-Hidhet në votim, P/Vendim-2 Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar .

Kush ëshirë dakord, pro-15

Kundra-C

Abstenim-0

Miratonet me 15 vota pro.

U votua pika 2 e rendit të ditës, me 15 vota pro ,kundra 0,kundershtime 0 , abstenime 0.

U hodh për diskutim pika 3 e rendit të ditës.

3-P/Vendim mbi miratimin e përdorimit të të ardhurave të trashëguara të vitit 2023 shtesë në Buxhetin e vitit 2024.

3.1 Relacion mbi miratimin e përdorimit të të ardhurave të trashëguara të vitit 2023 shtesë në Buxhetin e vitit 2024.

Kryetari i Këshillit të Qarkut Korçë Z. Erjon Nexhipi . Ka pyetje, apo diskutime në lidhje me këtë pikë? - jep fjalën, komisioneve, të cilët thanë nuk kemi gjë për të shtuar i jep fjalën Kryetarit të grupit të këshilltarëve Z. Gezim Topçiu , i cili tha: nuk kam gjë për të shtuar, i jep fjalën, këshilltarëve, të cilët thanë nuk kemi gjë për të shtuar. i jep fjalën. Pergjegjes i Sektorit te Finances dhe Buxhetit, znj. O.Beqiraj e cila relatoj mbi miratimin e përdorimit të të ardhurave të trashëguara të vitit 2023 shtesë në Buxhetin e vitit 2024 .Relacion mbi miratimin e përdorimit të të ardhurave të trashëguara të vitit 2023 shtesë në Buxhetin e vitit 2024. Të miratojë shtimin në buxhet të të ardhurave të parashikuara për tu realizuar nga kontributet e Bashkive në vlerën 4307000 si dhe alokimin e kësaj vlere sipas strukturave më poshtë:

00/04130/05/231 3280000 lekë (Investime në sektorin e turizmit në bashkëpunim me bashkitë)

00/06260/05/230 1027000 lekë (Projekte studimi ne bashkëpunim me bashkitë)

2. Të miratojë detajimin e zërit “Investime në sektorin e turizmit në bashkëpunim me bashkitë” si më poshtë:

a) Pakësohet

00/04130/01/231/ me kod projekti 0150072 17920000 lekë (Investime në sektorin e turizmit në bashkëpunim me bashkitë)

00/04130/05/231/ me kod projekti 0150072 23280000 lekë (Investime në sektorin e turizmit në bashkëpunim me bashkitë)

00/04130/02/231/ me kod projekti 0150072 17000000 lekë (Investime në sektorin e turizmit në bashkëpunim me bashkitë)

b) Shtohen

00/04130/01/231 1200000 lekë (Rikonstruksioni i monumenteve të Lasgush Poradecit dhe Mitrush Kutelit në Bashkinë Pogradec)

00/04130/05/231 800000 lekë (Rikonstruksioni i monumenteve të Lasgush Poradecit dhe Mitrush Kutelit në Bashkinë Pogradec)

00/04130/01/231 1500000 lekë(Investim, rikonstruksion i muzeut Dritëro Agolli, Devoll)

00/04130/05/231 1000000 lekë(Investim, rikonstruksion i muzeut Dritëro Agolli, Devoll)

00/04130/01/231 1000000 lekë(Rikonstruksion i muzeut etnografik në Bashkinë Korçë)

00/04130/02/231 17000000 lekë(Rikonstruksion i muzeut etnografik në Bashkinë Korçë)

00/04130/05/231 12000000 lekë(Rikonstruksion i muzeut etnografik në Bashkinë Korçë)

00/04130/01/231 720000 lekë(Pajisje për qendrën Infopoint në qytetin e Ersekës)

00/04130/05/231 480000 lekë(Pajisje për qendrën Infopoint në qytetin e Ersekës)

3. Të miratojë detajimin e zërit “Projekte studimi në bashkëpunim me bashkitë” si më poshtë

a) Pakësohet

00/06260/01/230 me kod projekti 0150079 8645193.04 lekë (Projekte studimi në bashkëpunim me bashkitë)

00/06260/05/230 me kod projekti 0150079 4027000 lekë (Projekte studimi në bashkëpunim me bashkitë)

00/06260/05/230 me koc projekti U1500/9 /50806.96 lekë (Projekte studimi në bashkëpunim me bashkitë)

b) Shtohen

00/06250/01/230 1050000 lekë (Projekt studimi, Muzeu i sazeve në Leskovik, B.Kolonjë)

00/06250/05/230 450000 lekë (Projekt studimi, Muzeu i sazeve në Leskovik, B.Kolonjë)

00/06250/01/230 3500000 lekë (Projekt studimi në Bashkinë Pustec)

00/06250/05/230 1500000 lekë (Projekt studimi në Bashkinë Pustec)

00/06250/01/230 646000 lekë (Projekt preventiv zbatimi për objektin "Rehabilitimi Lagjia Muze Maliq")

00/06250/05/230 277000 lekë (Projekt preventiv zbatimi për objektin "Rehabilitimi Lagjia Muze Maliq")

00/06250/01/230 3449193.04 lekë (Projekt preventiv zbatimi për objektin "Ndërtim i Muzeut të palafiteve të tharjes të Kënetës së Maliqit)

00/06250/05/230 750806.96 lekë (Projekt preventiv zbatimi për objektin "Ndërtim i Muzeut të palafiteve të tharjes të Kënetës së Maliqit)

00/06250/05/230 1800000 lekë (Projekt preventiv zbatimi për objektin "Ndërtim i Muzeut të palafiteve të tharjes të Kënetës së Maliqit)

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i Financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerëzore dhe zhvillimit të territorit, të gjithë zyrat e administratës së Këshillit të Qarkut, Dega e Tësarit.

-Hidhet në votim. P/Vendim-3 mb: miratimin e përdorimit të të ardhurave të trashëguara të vitit 2023 shtesë në Buxhetin e vitit 2024. 3.1 Relacion mbi miratimin e përdorimit të të ardhurave të trashëguara të vitit 2023 shtesë në Buxhetin e vitit 2024.

Kush është dakord, pro-15

Kundra-C

Abstenim-0

Miratohet me 15 vota.

U votua pika 3 e rendit të ditës, me 15 vota pro ,kundra 0,kundershtime 0 , abstenime 0.

U hodh për diskutim pika 4 e rendit të ditës.

4- P/Vendim mbi miratimin e Rregullores së funksionimit të Këshillit të Qarkut Korçë

4.1 Relacion mbi miratimin e Rregullores së funksionimit të Këshillit të Qarkut Korçë

Kryetari i Këshillit të Qarkut Korçë Z. Erjon Nexhipi. Ka pyetje ,apo diskutime në lidhje me këtë pikë? i jep fjalën, komisioneve , të cilët thanë nuk kami gjë për të shtuar i jep fjalën Kryetari i grupit të këshilltarve Z. Gezim Topçiu , i cil tha: nuk kam gjë për të shtuar, i jep fjalën, këshilltarve , të cilët thanë nuk kami gjë për të shtuar, i jep fjalën. Drejtor i kabinetit te kryetarit - Keshilltar juridik Z.GJ. Kristo : cili relatoi. mbi miratimin e Rregullores së funksionimit të Këshillit të Qarkut Korçë Relacion mbi miratimin e Rregullores së funksionimit të Këshillit të Qarkut Korçë Qëllimi i kësaj Rregulloreje është:

1. Të mundësojë rregullimin e funksionimit dhe kontrollin e vendimmarrjes së Këshillit të Qarkut.
2. Të garantojë një vendimmarrje të ligjshme dhe efikase të Këshillit.
3. Të harmonizojë e forcojë marrëdhëniet institucionale, duke përcaktuar modalitetet e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit dhe Kryetarit të Këshillit dhe administratës së Këshillit.
4. Të garantojë ushtrimin efektiv të së drejtës së përfaqësimit politik.
5. Të garantojë dhe të mundësojë ushtrimin e të drejtës së komunitetit dhe personave fizikë e juridikë, për t'u informuar për punët e dhe vendimmarrjen e Këshillit të Qarkut.
6. Të garantojë dokumentimin e plotë dhe administrim eficient të punës së Këshillit.
7. Të garantojë zbatimin në vazhdimësi të vendimmarrjes së Këshillit.

1. Qarku i Korçës si njësi e nivelit të dytë të vetëqeverisjes vendore, përfaqëson një unitet administrativo-territorial, të përbërë nga 6 (gjashtë) bashki me lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike, sociale dhe interesa të përbashkëta. Kufijtë e qarkut përputhen me kufijtë e 6 (gjashtë) bashkive që e përbëjnë atë, kje sipas Ligjit Nr. 115/2014 "Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësisve të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë. Qendra e qarkut është në Korçë pjesë përbërëse e Bashkisë Korçë.

2. Bashkëto perberese te Qakut te Korçes janë:

- Bashkia e Devollit
- Bashkia e Kolonjës
- Bashkia e Korçës
- Bashkia e Maliqit
- Bashkia e Pogradecit
- Bashkia e Pustecit

-Hidhet në votim. P/Vendim 4 mbi miratimin e Rregullores së funksionimit të Këshillit të Qarkut Korçë 4.1 Relacion mbi miratimin e Rregullores së funksionimit të Këshillit të Qarkut Korçë Kryetari i Këshillit të Qarkut Korçë Kush është dakord, pro-15

Kundra-0

Abstenime-0

Miratohet me 15 vota.

U votua pika 4 e rendit të ditës, me 15 vota pro, kundra 0, kundërshtime 0, abstenime 0.

U hodh për diskutim pika 5 e rendit të ditës.

5- P/Vendim mbi ndryshimin e Strukturës organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë.

5.1 Relacion mbi ndryshimin e Strukturës organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë Kryetari i Këshillit të Qarkut Korçë Z. Erjon Nexhipi . Ka pyetje ,apo diskutime në lidhje me këtë pikë? i jep fjalën, komisioneve , të cilët thanë nuk kam gjë për të shtuar i jep fjalën Kryetari i grupit të këshilltarve Z. Gezim Topçiu , i cil: tha: nuk kam gjë për të shtuar, i jep fjalën, këshilltarve , të cilët thanë nuk kam gjë për të shtuar, i jep fjalën. Drejtor i kabinetit te kryetarit - Keshilltar juridik Z.GJ. Kristo i cili relatoi, mbi ndryshimin e Strukturës organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë. Relacion mbi ndryshimin e Strukturës organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë

1. **Kryetari i Këshillit të Qarkut;** mban pozicionin si funksionar i zgjedhur. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është bazuar në lidhjen nr. 1, pika “e”, përcaktuar sipas VKM nr. 328, datë 31.05.2023
2. **Zëvendëskryetari i Këshillit të Qarkut;** mban pozicionin si funksionar i zgjedhur. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është bazuar në lidhjen nr. 1, pika “e”, përcaktuar sipas VKM nr. 328, datë 31.05.2023
3. **Sekretari i Këshillit të Qarkut;** mban pozicionin si funksionar i emëruar nga Këshilli i Qarkut. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është përcaktuar në pikën “6”, shkronja “c” dhe konfirmuar në lidhjen nr. 8, të VKM nr. 328, datë 31.05.2023, përkatësisht i përket klasa “I”, Kategoria “I-b”, grup diplome “1”

II. Kabineti i Kryetarit

Kabineti i kryetarit, si strukturë ndihmëse e përbërë nga funksionarë të emëruar, të cilët ushtrojnë veprimtari të drejtpërdrejtë ndihmëse për realizimin e funksioneve politike sipas parashikimeve të nenit 13. të Ligjit nr. 8095, datë 21.03.1996 “Për Shërbimin Civil” i ndryshuar si më poshtë:

1. **Drejtor i Kabinetit të kryetarit dhe këshilltar juridik;** mban pozicionin si funksionar i emëruar nga Kryetari i Këshillit të Qarkut. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është përcaktuar në pikën “6”, shkronja “c” dhe e konfirmuar në lidhjen nr. 8, të VKM nr. 328, datë 31.05.2023, përkatësisht i përket klasa “I”, Kategoria “I-b”, grup diplome “1”.
2. **Këshilltar për Teknologjinë dhe Komunikimin;** mban pozicionin si funksionar i emëruar nga Kryetari i Këshillit të Qarkut. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është përcaktuar në pikën “6”, shkronja “ç” dhe e konfirmuar në lidhjen nr. 8, të VKM nr. 328, datë 31.05.2023, përkatësisht i përket klasa “II”, Kategoria “II-b”, grup diplome “1”.
3. **Këshilltar për Projektet e Bashkimit European;** mban pozicionin si funksionar i emëruar nga Kryetari i Këshillit të Qarkut. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është përcaktuar në pikën “6”, shkronja “ç” dhe e konfirmuar në lidhjen nr. 8, të

III. Sektori i financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerëzore dhe zhvillimit të territorit.

Në përbërjen e këtij sektori do të jenë gjashtë nëpunës civilë sipas Ligjit Nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar:

1. **Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Buxhetit;** mban pozicionin si nëpunës civil. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është përcaktuar në pikën "8", dhe e konfirmuar në lidhjen nr. 8, të VKM nr. 328, datë 31.05.2023, përkatësisht i përket klasa "III", Kategoria "III-a", grup diplome "1".
2. **Specialist për Shërbimet, Burimet Njerëzore dhe Emergjencat Civile;** mban pozicionin si nëpunës civil. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është përcaktuar në pikën "8", dhe e konfirmuar në lidhjen nr. 8, të VKM nr. 328, datë 31.05.2023, përkatësisht i përket klasa "III", Kategoria "III-b", grup diplome "1 ose 2".
3. **Specialist për Urbanistikën dhe Zhvillimin e Territorit;** mban pozicionin si nëpunës civil. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është përcaktuar në pikën "8", dhe e konfirmuar në lidhjen nr. 8, të VKM nr. 328, datë 31.05.2023, përkatësisht i përket klasa "III", Kategoria "III-b", grup diplome "1 ose 2".
4. **Specialist për programet e zhvillimit;** mban pozicionin si nëpunës civil. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është përcaktuar në pikën "8", dhe e konfirmuar në lidhjen nr. 8, të VKM nr. 328, datë 31.05.2023, përkatësisht i përket klasa "III", Kategoria "III-b", grup diplome "1 ose 2".
5. **Specialist për Shëndetsinë dhe Çështjet sociale, arsimin dhe Kulturën;** mban pozicionin si nëpunës civil. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është përcaktuar në pikën "8", dhe e konfirmuar në lidhjen nr. 8, të VKM nr. 328, datë 31.05.2023, përkatësisht i përket klasa "III", Kategoria "III-b", grup diplome "1 ose 2".
6. **Specialist i arkiv/protokollit.** Pozicioni i propozuar bazuar në nevojat e institucionit dhe dispozitave ligjore në fuqi. Është punonjës me status civil me kategorinë nëpunës ekzekutiv. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është përcaktuar në pikën "8", dhe e konfirmuar në lidhjen nr. 8, të VKM nr. 328, datë 31.05.2023, përkatësisht i përket klasa "III", Kategoria "III-b", grup diplome "1 ose 2".

IV. Punonjës administrative.

1. **Shofer autoveture i institucionit;** mban pozicionin si punonjës administrativ. Klasa dhe kategoria e pagës për pozicionin e punës është përcaktuar në pikën "11", të VKM-së nr. 328, datë 31.05.2023.

Z. Erjon Nexhipi sqaroi se ky ndryshim i Strukturës organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut

-Hidhet në votim. P/Vendim-5 mbi ndryshimin e Strukturës organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë. Relacion mbi ndryshimin e Strukturës organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë

Kush është dakord, pro-15

Kundra-0

Abstenim-0

Miratohet me 15 vota.

U votua pika 5 e rendit të ditës, me 15 vota pro, kundra 0, kundërshtime 0, abstenime 0

U hodh për diskutim pika 6 e rendit të ditës.

6- P/Vendim mbi miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Administratës të Këshillit të Qarkut Korçë. 6.1 Relacion mbi miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Administratës të Këshillit të Qarkut Korçë

Kryetari i Këshillit të Qarkut Korçë Z. Erjon Nexhipi. Ka pyetje apo diskutime në lidhje me këtë pikë ? I jep fjalën, komisioneve, të cilët thanë nuk kemi gjë për të shtuar i jep fjalën Kryetari i grupit të këshilltarëve Z. Gezim Topçiu, i cili tha: nuk kam gjë për të shtuar, i jep fjalën, këshilltarëve, të cilët thanë nuk kemi gjë për të shtuar, i jep fjalën. Drejtor i kabinetit të kryetarit - Këshilltar juridik Z.GJ. Kristo i cili relatoi mbi miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Administratës të

Këshillit të Qarkut Korçë. Relacion mbi miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Administratës të Këshillit të Qarkut Korçë, Administrata e Këshillit të Qarkut Struktura Administrative e Këshillit të Qarkut Korçë përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i këshillit të qarkut si funksionarë politikë dhe 10 punonjës si personel administrativ të përcaktuar sipas ligjit për buxhetin.

Përbërja e strukturës është si më poshtë:

1. Kabineti i kryetarit, si strukturë ndihmëse e përbërë nga funksionarë të emëruar, të cilët ushtrojnë veprimtari të drejtpërdrejtë ndihmëse për realizimin e funksioneve politike sipas parashikimeve të nenit 13, të Ligjit nr.8095, datë 21.03.1996 "Për Shërbimin Civil" i ndryshuar.

a) Drejtori i kabinetit të kryetarit njëkohësisht dhe këshilltar juridik

b) Këshilltar për teknologjinë dhe komunikimin

c) Këshilltar për projektet e bashkimit evropian

2. Sektori i financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimet njerëzore dhe zhvillimit të territorit, i përbërë nga nëpunës civilë sipas Ligjit Nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar.

a) Përgjegjës i sektorit të financës dhe buxhetit

b) Specialist i nivelit të lartë për shërbimet, burimet njerëzore dhe emergjencat civile

c) Specialist i nivelit të lartë për urbanistikën dhe zhvillimin e territorit

ç) Specialist i nivelit të lartë për programet e zhvillimit

d) Specialisti për shëndetësinë dhe çështjet sociale, arsimin dhe kulturën

e) Specialist Arkiv/Protokolli

3. Punonjës administrativ që kryen veprimtari administrative shërbimi dhe nuk ushtron një funksion publik

a) Shoferi i autoveturës së institucionit.

Gjithashtu i bashkëngjitet edhe funksioni i deleguar nëpërmjet Drejtorisë së administrimit dhe mbrojtjes së tokës.

4. Drejtoria e administrimit dhe mbrojtjes së tokës pranë këshillit të qarkut

a) Sektori i administrimit të tokës, si funksion i deleguar, i cetyrueshëm, i Këshillit të Ministrave i përbërë nga :

- Drejtori dhe 3 (tre) specialistë - Zyra e administrimit dhe mbrojtjes së tokës Korçë

- Specialisti i Zyrës së administrimit dhe mbrojtjes së tokës Devoll

- Specialisti i Zyrës së administrimit dhe mbrojtjes së tokës Kolenjë

- Specialisti i Zyrës së administrimit dhe mbrojtjes së tokës Pogradec

b) Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës (IMT) në nivel sektori, si funksion i Këshillit të Qarkut.

-Hidhet në votim. P/Vendim-6 mbi miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Administratës të Këshillit të Qarkut Korçë. Relacion mbi miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Administratës të Këshillit të Qarkut Korçë

Kush është dakord, pro-15

Kundra-0

Abstenim-0

Miratohet me 15 vota.

U votua pika 6 e rendit të ditës, me 15 vota pro, kundra 0, kundërshtime 0, abstenime 0.

U hodh për diskutim pika 7 e rendit të ditës.

7- P/Vendim mbi dhënien në huapërdorje në favor të institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë, katin e parë të godinës e cila është në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë. 7.1 Relacion mbi dhënien në huapërdorje në favor të institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë, katin e parë të godinës e cila është në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë.

Kryetari i Këshillit të Qarkut Korçë Z. Erjon Nexhipi. Ka pyetje apo diskutime në lidhje me këtë pikë? I jep fjalën, komisioneve, të cilët thanë nuk kemi gjë për të shtuar i jep fjalën Kryetarit të grupit të këshilltarëve Z. Gezim Topçiu, i cili tha: nuk kam gjë për të shtuar, i jep fjalën këshilltarve, të cilët thanë nuk kemi gjë për të shtuar, i jep fjalën. Drejtor i kabinetit të kryetarit - Këshilltar juridik Z.GJ. Kristo i cili relatoi mbi dhënien në huapërdorje në favor të institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë, katin e parë të godinës e cila është në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë. 7.1 Relacion mbi dhënien në huapërdorje në favor të institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë, katin e parë të godinës e cila është në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë. 1. Të miratojë dhënien në huapërdorje në favor të

institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë, të katit të parë të godinës e cila është në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë me të dhënat, Pasuria nr. 2/708-N2, Vol. 43 Fq. 82 në ZK. 8564, me sipërfaqe 552.28 m² ndodhur në Lagja 7, Fruga "28 Nëntori" nr.1, Korçë

2. Periudha për të cilën kati i parë i godinës i specifikuar në pikën 1 të Vendimit, do të lihet në huapërdorje institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë do të jetë 3 vjet nga përfundimi i afatit të kontratës aktuale (17.07.2024 -17.07.2027).

-Hidhet në votim. P/Vendim 7 mbi dhënien në huapërdorje në favor të institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë, katin e parë të godinës e cila është në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë. 7.1

Relacion mbi dhënien në huapërdorje në favor të institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë, katin e parë të godinës e cila është në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë.

Kush është dakord, pro-15

Kundra-0

Abstenim-0

Miratohet me 15 vota.

U votua pika 7 e rendit të ditës, me 15 vota pro ,kundra 0,kundërshime 0 , abstenime 0.

U hodh për diskutim pika 8 e rendit të ditës.

8- P/Vendim mbi dhënien e pëlqimit për kalimin në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë të pasurive të identifikuar me Nr.2/12 vol.27 faqe 167, Nr.2/539-Nd, vol.27, faqe 168, trualli nën ndërtesën Nr.2/708-N1, pjesë e pasurisë Nr.2/10, vol.33, faqe 19. 8.1 Relacion "Për dhënien e pëlqimit për kalimin në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë të pasurive të identifikuar me Nr.2/12 vol.27 faqe 167, Nr.2/539-Nd, vol.27, faqe 168, trualli nën ndërtesën Nr.2/708-N1, pjesë e pasurisë Nr.2/10, vol.33, faqe 19.

Kryetari i Këshillit të Qarkut Korçë Z. Erjon Nexhipi. Ka pyetje apo diskutime në lidhje me këtë pikë? I jep fjalën, komisioneve, të cilët thanë nuk kemi gjë për të shtuar i jep fjalën Kryetarit të grupit të këshilltarëve Z. Gezim Topçiu, i cili tha: nuk kam gjë për të shtuar, i jep fjalën këshilltarve, të cilët thanë nuk kemi gjë për të shtuar, i jep fjalën. Drejtor i kabinetit të kryetarit - Këshilltar juridik Z.GJ.

Kristo i cili relatoi. mbi dhënien e pëlqimit për kalimin në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë të pasurive të identifikuar me Nr.2/12 vol.27 faqe 167, Nr.2/539-Nd, vol.27, faqe 168, trualli nën ndërtesën Nr.2/708-N1, pjesë e pasurisë Nr.2/10, vol.33, faqe 19. Relacion "Për dhënien e pëlqimit për kalimin në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë të pasurive të identifikuar me Nr.2/12 vol.27 faqe 167, Nr.2/539-Nd, vol.27, faqe 168, trualli nën ndërtesën Nr.2/708-N1, pjesë e pasurisë Nr.2/10, vol.33, faqe 19.

-Hidhet në votim. P/Vendim 8 mbi dhënien e pëlqimit për kalimin në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë të pasurive të identifikuar me Nr.2/12 vol.27 faqe 167, Nr.2/539-Nd, vol.27, faqe 168, trualli nën ndërtesën Nr.2/708-N1, pjesë e pasurisë Nr.2/10, vol.33, faqe 19. 8.1 Relacion "Për dhënien e pëlqimit për kalimin në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë të pasurive të identifikuar me Nr.2/12 vol.27 faqe 167, Nr.2/539-Nd, vol.27, faqe 168, trualli nën ndërtesën Nr.2/708-N1, pjesë e pasurisë Nr.2/10, vol.33, faqe 19.

Kush është dakord, pro-15

Kundra-0

Abstenim-0

Miratohet me 15 vota.

U votua pika 8 e rendit të ditës, me 15 vota pro ,kundra 0,kundershime 0 , abstenime 0.

U hodh për diskutim pika 9 e rendit të ditës.

9- P/Vendim mbi miratimin e shteses ne buxhet te fondit te ardhur nga donatori, nepermjet BSH-se , per rimbursimin e shpenzimeve te projektit CLLD(cultour) 9.1 Relacioni mbi miratimin e shteses ne buxhet te fondit te ardhur nga donatori, nepermjet BSH-se , per rimbursimin e shpenzimeve te projektit CLLD(cultour)

Kryetari i Këshillit të Qarkut Korçë Z. Erjon Nexhipi. Ka pyetje apo diskutime në lidhje me këtë pikë? I jep fjalën, komisioneve, të cilët thanë nuk kemi gjë për të shtuar i jep fjalën Kryetarit të grupit të këshilltarëve Z. Gezim Topçiu, i cili tha: nuk kam gjë për të shtuar, i jep fjalën këshilltarve, të cilët thanë nuk kemi gjë për të shtuar, i jep fjalën. Pergjegjes i Sektorit te Finances dhe Buxhetit, znj.

O.Beçiraj e cila relatoj mbi miratimin e shteses ne buxhet te fondit te ardhur nga donatori, nepermjet

BSH-se , per rimbursimin e shpenzimeve te projektit CLLD(cultour) Relacioni mbi miratimin e shteses ne buxhet te fondit te ardhur nga donatori, nepermjet BSH-se , per rimbursimin e shpenzimeve te projektit CLLD(cultour) Këshilli i Qarkut Korçë ka zbatuar 5 projekte të financuara me fondet e Bashkimit European. Si pjesë e zbatimit të tyre, institucioni ka planifikuar në buxhetin e saj gjatë gjithë kësaj periudhe, fonde për bashkëfinancimet dhe parafinancimet, sipas legjislacionit në fuqi. Duke qënë se donatori(BE) bën disbursimet pas verifikimit të shpenzimeve dhe aktiviteteve të kryera, lind nevoja e parafinancimit me vetë fondet e institucionit.

Konkretisht projekti CLLD(Cultour) ka përfunduar, pra nuk ka më aktivitete për tu realizuar, ndërkonë që ashtu si edhe për projektet e tjera nuk ka përfunduar disbursimi i të gjitha fondeve nga donatori.

Disbursimi i fundit që është bërë nga donatori në llogarinë speciale të Bankës të Shqipërisë për projektin CLLD, është 87043.7 euro, vlerë kjo e cila kaloi nga llogaria speciale e projektit CLLD në BSH, në llogarinë tonë në thesar duke u konvertuar në 9044710.87 lekë, për rimbursimin e shpenzimeve të kryera paraprakisht nga fondet tona buxhetore për këtë projekt.

Ky fond do ti bashkohet buxhetit të vitit 2024 sipas strukturave më poshtë:

00/08220/01/602 4084710.87 lekë (Bashkëfinancime në projektë të BE-së)

